

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe pasiguria politike
ADRESA	https://tpz.al/shqetesimet-e-bankave-rritet-perceptimi-i-rrezikut-nga-tregu-i-pronave-dh-e-pasiguria-politike-i333833
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 08:21:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 08:16:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0cceda0ea6ab436c0611cc2cc9978f4f56345f18fdfab34c89ce973953d413bd
TEKSTI	d0a1e96563c2f3efb76ee03fa5efde31495c85666745bcec2d7fabaeaa8f912f
PAMJA	300db50f84bd762c16961b736262cae80df92b6502b251a13ffe6d0fd77de5d9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	692ae20c39f8710c8085084c3283a403c27e4d7fa2cee79fe37719a34648f1a8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	03bdce4b1a721a6f1a89a4ef485ddb946ec31f15b1790ea3cb05a93e1803ce0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/692ae20c39f8710c8085084c3283a403c27e4d7fa2cee79fe37719a34648f1a8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

10:16 Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe pasiguria politike • 10:08 VIDEO/ Zbardhen prapaskenat e darkës Trump-Xi në Shtëpinë e B

AKTUALITET, 25 SEPTEMBER 2026, 10:16

Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe pasiguria politike

tpz.al TPZ



Rezultatet e vërtetimit mbi perceptimin e rreziqeve sistematike në vend nga sektori bankar tregojnë se, gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, renditja e rreziqeve kryesore dhe nivelet e perceptimit të tyre kanë paraqitur ndryshime, me rritje të shqetësimit të lidhur me çmimet e pronave dhe të atij politik, pas valës disamujore të protestave ndaj qeverisë.

Transferimi i goditjeve nga ekonomia e jashtme vijon të konsiderohet si rreziku sistematik më i rëndësishëm nga bankat. Pas një zbutjeje të përkohshme në gjysmën e dytë të vitit 2025, vlerësimi për këtë rrezik është rritur përsëri gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 nga niveli "mesatar" në "i lartë".

Kjo ecuri ka reflektuar pasigurinë e vazhdueshme në mjedisin ekonomik dhe gjeopolitik ndërkombëtar dhe potencialin e tyre për t'u transmetuar në ekonominë shqiptare.

Rreziku i lidhur me luhatjen e vlerës së pasurive të paluajtshme është klasifikuar si rreziku i dytë më i rëndësishëm sistematik i periudhës dhe vlerësimi për të është rritur duke kaluar nga niveli "i ulët", në "mesatar".

Rritja e vazhdueshme e çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe ekspozimi i konsiderueshëm i sektorit bankar ndaj këtij tregu vazhdojnë ta mbajnë këtë rrezik në grupin e faktorëve që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm.

Megjithatë intensiteti i perceptuar nga bankat nuk është i lartë, shqetësimi i tyre është në rritje, veçanërisht për ndikimin e mundshëm të një korrigjimi të çmimeve në vlerën e kolateralit dhe rrezikun e kredisë.

Përkeqësimi i ekonomisë së brendshme vijon të mbetet në grupin e rreziqeve më të rëndësishme sistematike në vend. Në perceptimin e bankave, vlerësimi për këtë rrezik është

ide!

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet

Nga Mero Baze

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë

Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërket largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Rreziku nga sulmet kibernetike vijon të perceptohet si një nga rreziqet kryesore sistemike. Megjithatë, vlerësimi i sektorit bankar për rëndësinë e tij ka rënë gjatë gjysmës së parë të vitit 2026 krahasuar me dy periudhat paraardhëse, gjë që mund të lidhet me investimet dhe strategjitë e ndërmarra nga bankat për të kufizuar këtë rrezik.

Pavarësisht kësaj, në kushtet e digjitalizimit gjithmonë e më të madh të shërbimeve financiare dhe kompleksitetit në rritje të kërcënimeve kibernetike, ky rrezik është bërë tashmë një nga sfidat kryesore të biznesit bankar.

Së fundi, perceptimi mbi rrezikun politik ka shënuar rritje krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2025, duke u përfshirë në listën e rreziqeve kryesore sistemike.

Rritja e këtij perceptimi mund të lidhet me shtimin e pasigurive rreth zhvillimeve politike dhe institucionale në vend, të cilat mund të ndikojnë në pritjet e agjentëve ekonomikë dhe në klimën e biznesit.

Megjithatë, në vlerësimin e bankave, rëndësia e këtij rreziku vlerësohet ende ndjeshëm më e ulët krahasuar me rreziqet e tjera të lartpërmendura.

Në terma të përgjithshëm, deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2026, bankat vlerësojnë se mundësia e materializimit të një ose disa prej rreziqeve sistemike në horizontin afatshkurtër (deri në një vit) mbetet nën nivelin mesatar, megjithëse ky perceptim është rritur lehtë krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.

Për horizontin afatmesëm (1–3 vjet), perceptimi i bankave për materializimin e këtyre rreziqeve mbetet më i lartë se ai afatshkurtër dhe ka shënuar gjithashtu rritje gjatë periudhës.

Nga ana tjetër, gjendja e mirë financiare e sektorit bankar dhe niveli i lartë i likuiditetit vijojnë të mbështesin besimin e bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar, i cili mbetet mbi nivelin mesatar dhe pothuajse i pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar./Monitor

AKTUALITET / 25 September 2026, 10:01

Detaje/ Plagosja e të riut në Lezhë, sherri nisi për pagesën e riparimit të makinës! Babë e bir në kërkim

AKTUALITET / 25 September 2026, 09:52

Rregulli i ri/ Preken dhe shqiptarët, Gjermania ul kuotën për punëtorët e huaj

AKTUALITET / 25 September 2026, 09:44

Operacioni/ Shisnin kokainë me motorin e shpërndarjes së ushqimeve, dy të arrestuar në Lushnje

AKTUALITET / 25 September 2026, 09:37

"Pamjet do t'ua dërgoj familjarëve"/ I mori 15 mijë euro dhe e kërcënoi me fotot nudo, shqiptari përfundon në polici në Rades

AKTUALITET / 25 September 2026, 09:22

Ngjarja e rëndë në Itali, shqiptari gjendet i vdekur në kantier! 51-vjeçari dyshohet se ra në hapësirën e ashensorit

AKTUALITET / 25 September 2026, 09:14

Kosto/ Në kulmin e krizës, pritët të shtohet taksë e re për naftën, 3 lekë për litër! Efekti, 40 milionë euro në vit

AKTUALITET / 24 September 2026, 22:13

Shehaj takim në Degën 5: Mundësia do të jetë në çdo Këshill Bashkiak. Koha për një frymë të re dhe një Shqipëri të drejtë

AKTUALITET / 24 September 2026, 21:34

QSUT me dorë të hekurt, mjekët dhe infermierët duhet të marrin miratim për daljet në media

AKTUALITET / 24 September 2026, 20:51

Arrestimi i Vlora Hysenit, Presidenti Begaj pritët të mbledhë Këshillin e Sigurimit Kombëtar javën e ardhshme

AKTUALITET / 24 September 2026, 20:40

Shqiptari humb jetën pasi ra në gropën e ashensorit në Itali, trupi u gjet falë ziles së celularit

AKTUALITET / 24 September 2026, 20:36

Reforma territoriale, Këshilli Bashkiak në Elbasan pro bashkimit me Cërrikun dhe Belshin

AKTUALITET / 24 September 2026, 20:31

Auron Tare: Historia e spiunazhit në Tiranë ia kalon edhe Luftës së Ftohtë

AKTUALITET / 24 September 2026, 20:23

Tabaku: Kërcënimi ndaj Klodiana Lalës tregon shtetin privat, ky sistem duhet çmontuar

AKTUALITET / 24 September 2026, 19:48

Sarandë, "arrest shtëpie" të dyshuarit për plagosje. Autori: Tentoi të më vidhte

AKTUALITET / 24 September 2026, 18:37

Pas arrestimit të Vlora Hysenit, caktohet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

AKTUALITET / 24 September 2026, 18:11

Grabitet banesa në fshatin Shelegar të Sarandës, hajdutët shfrytëzuan largimin e familjes në një dasmë! Morën miliona lekë dhe...

AKTUALITET / 24 September 2026, 17:35

Sulmi ndaj Klodiana Lalës/ SafeJournalists: Deklarata e Hysenit ngre shqetësime për mbikëqyrjen e gazetarëve

AKTUALITET / 24 September 2026, 16:54

"Shpreh solidaritet me Lalën"/ Shehaj: Një gazetare u sulmua, Rama të reagojë. Vlora Hyseni u tha mediave 'nëse merreni me mua, ju shantazhoj'

AKTUALITET / 24 September 2026, 16:47

Grabitet banesa në Sarandë, hajdutët shfrytëzuan largimin e familjes në një dasmë

AKTUALITET / 24 September 2026, 16:41

Masa e sigurisë ndaj Vlora Hysenit, ambasadori i Italisë: Cështiet e bashkëpunimit

